

2. VEPRIMET ME PALËT E LIDHURA

Banka Kombëtare Tregtare publikon në baza tremujore të gjithë tepricat dhe veprimet me palët e lidhura me të, si pjesë e raportimit periodik të Bankës të pasqyrave financiare SNRF.

Informacioni i mëposhtëm me palët e lidhura përbëhet nga Shenimi nr. 34 i raportit të fundit të rishikimit të BKT-së (Banka) sipas SNRF më datë 31 dhjetor 2023, i nënshkruar nga Mazars sh.p.k. më 26 mars 2024.

Veprimet me palët e lidhura

Sipas SNK 24 “Palët e lidhura”, një palë e lidhur është çdo njësi që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Identiteti i palëve të lidhura

Banka ka marrëdhënie si person i lidhur me aksionarët, drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë të saj. Aksionari i vetëm i Bankës është Çalik Holding me 100% më 31 dhjetor 2023. Çalik Holding kontrollohet nga një individ i vetëm, Z. Ahmet Calik.

Aktiv Yatirim Bankasi A.S. (“Aktifbank”), ArkEstate Investment Sh.A, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (KEDS), Çalik Elektrik Dagitim A.S & Çalik Enerji A.S. Consortium, Çalik Pamuk Dogal Vesen El Tic As, Aktiv Tech dhe Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH. A. (KESCO) kontrollohen nga Çalik Holding. Albania Leasing Sh.A përfaqëson filialin e Bankës.

Balancat dhe veprimet me palët e lidhura

	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
Aktivët		
<i>Depozita dhe llogarite me bankat:</i>		
Llogaritë rrjedhëse me Aktivbank	88,410	112,198
Depozita me Aktivbank	-	14,940,217
Huadhënie Aktivbank	14,371,583	-
Letra me vlere me Çalik Holding	26,334,823	18,892,512
<i>Hua dhe paradhënie për klientët:</i>		
ArkEstate	14,404,069	5,568,248
Totali i aktiveve	55,198,885	39,513,175
<i>Pasivët</i>		
<i>Huamarrje me bankat dhe institucionet financiare:</i>		
Huamarrje me Aktivbank	10,762,697	15,080,244
<i>Depozitat e klientëve:</i>		
Albania Leasing	71,825	79,420
Çalik Pamuk Dogal Vesen El Tic As	111,013	-
Çalik Elektrik Dagitim A.S And Çalik Enerji A.S.	-	-
Consortium	12	-
KEDS / KESCO	11,700,522	19,057,455
Çalik Holding	15,041,883	-
<i>Other Liabilities:</i>		
Dividend për t’u paguar ndaj Çalik Holding	-	50,000,000
Totali i detyrimeve	37,687,952	84,217,119

	2023	2022
Pasqyra permbledhese e te ardhurave		
<i>Të ardhura të interesit nga:</i>		
Albania Leasing	-	6
Aktifbank	371,583	586,900
Calik Holding	3,021,297	372,862
ArkEstate	647,965	3,272
<i>Shpenzime interesi për:</i>		
Aktifbank	(77,999)	(150,992)
Calik Holding	(362,056)	-
<i>Tarifa dhe komisione:</i>		
Albania Leasing	4,107	3,707
KEDS / KESCO	42,817	35,204
<i>Shpenzime operative</i>		
Çalik Holding dhe AktifTech	(1,128,773)	(514,144)
Neto	2,518,942	336,815

Tepricat dhe veprimet me drejtorët dhe drejtuesit ekzekutivë

Shpërblimi i drejtorëve dhe drejtuesve ekzekutivë përshihet në shpenzimet e personelit. Detajet paraqiten më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2023	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2022
Drejtorët	2,211,260	2,004,327
Drejtuesit ekzekutivë	4,031,046	4,358,157
	6,242,306	6,362,484

Më 31 dhjetor 2023, depozitat totale të drejtorëve pranë Bankës ishin 4,418,573 USD (31 dhjetor 2022: 4,495,731 USD), ndërsa teprica e huave të dhëna drejtorëve ishte 1,054,164 USD (31 dhjetor 2022: 540,572 USD).